

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Pastrimi i Njësive Administrative Himarë, Horë, Vranisht” - Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90910000-9 - Shërbime të pastrimit, 98341130-5 – Shërbime pastrimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit: 256,568,919 (dyqindpesëdhjetegjashtëmilion e pesëqindegjashtëdhjetetetëmijë e nëntëqindenëntëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,585,077.26 (dymilion e pesëqindetetëdhjetë e pesëmijë e shtatëdhjeteshtatë.26) Euro pa TVSH. *(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (99,25), datë 07.04.2025).*

Burimi i financimit: Financimi për vitet buxhetore 2025÷2027 është në përputhje me vlerën e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 39 datë 20.12.2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si Institucion në varësi të Bashkisë Himarë”.

Procedura e prokurimit do të jetë e llojit: E Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar mbështetur në nenin 42 të Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenin 47 të V.K.M. Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, V.K.M. Nr. 291 datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik”, meqënëse vlera e fondit limit është mbi kufirin e lartë monetar, Udhëzimin nr. 6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” të ndryshuar.

Arsyeja e përdorimit të Marrëveshjes Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara është pasi Autoriteti Kontraktor ka nevojë për shërbime të një natyre të përsëritur ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, sasitë, specifikimet) duke qënë se ky shërbim është një shërbim me natyrë të përsëritur vit pas viti dhe për të realizuar shërbimin e pastrimit pa ndërprerje, duke eliminuar shtesa dhe amendamente të fillim vitit.

Është gjykuar e arsyeshme aplikimi i kontratës shumëvjeçare, duke qënë se në rastin konkret kontrata shumëvjeçare garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e realizimit në kohë të shërbimit, si dhe qëndrueshmëri në kryerjen me cilësi të shërbimit.

Gjykohet e arsyeshme dhe e argumentuar se lidhja e një kontrate shumëvjeçare, rrit efikasitetin dhe shmanget vonesat apo mos ofrimin në kohë të këtij shërbimi ndaj qytetarëve, të cilat mund të vijnë

për shkaqe të ndryshme objektive që nuk varen nga autoriteti kontraktor, ndërkohe që domosdoshmëria për këtë shërbim është me rëndësi shumë të madhe për komunitetin, duke marrë në konsideratë faktin që ky shërbim përbën interes publik të rëndësisë së veçantë, me karakter të përditshëm dhe të vazhdueshëm.

Kërkesat e autoritetit kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, janë realizimi i vazhdueshëm, eficient dhe me cilësi i shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane).

Për këtë arsye, kërkesa e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë është që shërbimi i pastrimit të kryhet me mjete teknologjike bashkohore, me staf të specializuar dhe eficientë. Të gjitha këto kërkesa përkthehen në shërbime cilësore dhe mjedis sa më të pastër.

Kontratat shumëvjeçare krijojnë një raport më të mirë ndërmjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për shërbime cilësore dhe kostos që kanë operatorët ekonomikë për ti ofruar këto shërbime me kapacitete optimale.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

“PASTRIMI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE HIMARË, HORË, VRANISHT”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, neni 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 83 “Sigurimi ofertës”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar:

Neni 83 i LPP parashikon se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të kontrates konkretisht 256 568 922 (dyqindpesëdhjetegjashtëmilion e pesëqind e gjashtëdhjetetetë mijë e nëntëqind e nëntëzet e dy) Lekë.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejt me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Liçencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL), Kategoria III.2 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, Nënkatëgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”.

- Leje Mjedisë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL), Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, Nënkatëgoria Leje Mjedisë tipi B “Magazinin i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontenerët ose nga larjet e kontenerëve.

Në rast bashkimi operatorësh të paktën njëri nga operatorët duhet të jetë i pajisur me Lejet e mësipërme në raport me zërat që ka marrë përsipër të kryejë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.2 është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjin nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi liçenca me (kodi III.2.B dhe III.1.B) janë në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
SSH EN ISO 9001:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

SSH EN- ISO 45001:2023 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë” ose ekuivalente /të barazvlefshme

Në rast bashkimi operatorësh ky kriter duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Çertifikimet e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer e të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj, të jenë të vlefshme, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh, përveç certifikimeve të cilat lidhen me procese të veçanta të cilat duhet të plotësohen në përputhje me zërat/proceset e marra përsipër në bashkëpunim.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit.

Duke marrë në konsideratë faktin se standarti S SH EN ISO 14001:201, “Sisteme të menaxhimit të mjedisit”, SSH EN ISO 9001: 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” dhe SSH EN- ISO 45001:2023 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë” specifikojnë kërkesat për sistemin e menaxhimit të mjedisit, sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, për t’i krijuar mundësinë një organizate të zhvillohet dhe të implementojë (ose zbatojë) një politikë dhe objektiva të cilat marrin parasysh kërkesat ligjore dhe

kërkesa të tjera në lidhje me aspekte të rëndësishme mjedisore, vlerësohet se plotësimi i këtij standarti lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që shërbimi i pastrimit do të kryhet konform standarteve të kërkuara, për mbrojtjen e mjedisit ku do të kryhet ky shërbim, mbrojtje e cila ndihmon në parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të banorëve apo garantimin e kryerjes me cilësi të shërbimit dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve dhe jo vetëm. Gjithashtu është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, të mjedisit dhe i sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri i mësipërm për paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për objektin e marrëveshjes kuadër/kontratës, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Diplomë;
- b) CV përkatëse;
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit), shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Diplomë;
- b) CV-në përkatëse;

c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

- 1 (një) punonjës të licencuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Liçencë;

b) CV-në përkatëse;

c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës”.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vërtetohen në CV përkatëse të tij. Kërkesa që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinier mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këtë kriter. Autoritetit Kontraktor nuk e ka kufizuar kriterin me disponimin e një profili të caktuar sic është inxhinieri mjedisit por duke u nisur nga parimet e parashikuara në LPP-në ka vendosur dhe mundësinë e plotësimit të kriterit nëpërmjet një eksperti mjedisi i cili jo detyrimisht duhet të jetë inxhinier mjedisi. Kjo për faktin se kriteri nuk do të ishte diskriminues dhe do të paraqiste një rëndësi të veçantë për hapjen e konkurrencës. Profili i inxhinierit të mjedisit ose ekspertit në fushën e mjedisit lidhet ngushtësisht dhe pashmangërisht me objektin e prokurimit.

Cdo profil tjetër duke marrë në konsideratë llojin dhe natyrën e shërbimit dhe legjislacionit në fuqi mund të krijonte problematika të mëdha jo vetëm për operatorin ekonomik por dhe për autoritetin kontraktor. Qyteti i Himarës, dhe në përgjithësi gjithë territori i Bashkisë, ka zona të gjelbërta në një nivel të kënaqshëm dhe plazhe të menaxhuara në mënyrë të përshtatshme. Aktualisht Bashkia Himarë depoziton mbetjet urbane në landfillin e Bajkat, Bashkia Delvinë. Në zonën bashkiake akoma praktikohet depozitimi pa dallim dhe ilegalisht i mbetjeve, duke krijuar një problem serioz për zonat përreth sidomos në Njësinë Administrative Horë-Vranisht. Për më tepër në Bashkinë e Himarës nuk ekziston një nivel i sigurt ruajtjeje dhe deponimi për mbetjet e rrezikshme. Në këto kushte kërkesa që operatorët ekonomik duhet të disponojë një inxhinier mjedisi ose ekspert në fushën e mjedisit lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik për të paktën muajin e fundit stafin si më poshtë:

- 6 (gjashtë) Shoferë të pajisur me Leje Drejtimi dhe Çertifikatë Aftësimi Profesional.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës”.

Nga ana e autoriteti kontraktor është kërkuar ky numër shoferësh duke u bazuar dhe tek numri i mjeteve të kërkuara si dhe duke patur parasysh sezonin turistik dhe fluksin e lartë të turistëve që vjen gjithmonë e në rritje që paraqitet në këto zona gjithashtu duke marrë në konsideratë siç thamë faktin se në sezonin turistik kërkohet një numër më i madh personeli nisur dhe nga eksperiencia e autoritetit kontraktor lidhur me ofrimin e këtij shërbimi.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 50 (pesëdhjetë) persona, për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fuqisë punëtore prej 50 (pesëdhjetë), për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Për punonjësit e mësipërm të paraqiten listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 50 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës. Po t’i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nga ana e autoriteti kontraktor është kërkuar ky numër punëtorësh duke u bazuar dhe

tek numri i mjeteve të kërkuara si dhe duke patur parasysh sezonin turistik dhe fluksin e lartë të turistëve që vjen gjithmonë e në rritje që paraqitet në këto zona gjithashtu duke marrë në konsideratë sic thamë faktin se në sezonin turistik kërkohet një numër më i madh personeli nisur dhe nga eksperiencia e autoritetit kontraktor lidhur me ofrimin e këtij shërbimi.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emertimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasitë përkatëse për mjetet si me mëposhte:

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, jo më pak se 2 (dy) copë EURO 5 (në pronësi ose me qira)
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 5 ton, jo më pak se 4 (katër) copë EURO 5 (në pronësi ose me qira)
- c) Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues jo më shumë se 3.5 ton, jo më pak se 4 (katër) copë; (në pronësi ose me qira)
- d) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-10 mijë litra ujë, jo më pak se 2 (dy) copë; (në pronësi ose me qira)
- e) Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenitorëve pa sjellë dëmtimin e tyre 1 (nje) copë: (në pronësi ose me qira)
- f) Makine teknologjike për fshirjen e rrugëve e pajisur me fshesa anësore ose qëndrore (autofshesë) 1 (një) copë: (në pronësi ose me qira)
- g) Të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë, jelekë për veshje të të punësuarve 50 copë dhe mushama shiu trupore 50 copë.

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruar në pronësi që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Për mjetet e deklaruar me qera që shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqesë kontratën e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me

të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

- Për mjetet në pronësi/qera apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 14 ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

Në zbatim të nenit 26 të LPP ku përcaktohet se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike” ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet *„Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën“*, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duke provuar përshtatshmërinë e operatorëve ekonomikë për të kryer veprimtarinë profesionale kanë në dispozicion kapacitetet teknike. Vendosja e kriterit për mjetet është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve. Po t'i referohemi preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë është plotësisht i justifikuar numri i mjeteve dhe pajisjeve. Vendosja e kriterit për mjetet është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbime. Po t'i referohemi preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë është plotësisht i justifikuar numri i mjeteve. Gjithashtu në lidhje me numrin e mjeteve të kërkuara, autoriteti kontraktor është bazuar dhe tek fakti që kemi të bëjmë me një vend turistik dhe për shkak të fluksit të lartë që mund të ketë gjatë sezonit si dhe për të ofruar një shërbim sa më të shpejtë dhe më të pastër ka përcaktuar këtë numër mjetesh. Në lidhje me kriterin Euro 5 autoriteti kontraktor e ka parë të arsyeshme që për mjetet teknologjike të kapacitetit të lartë duhet të jenë brenda standarteve të parashikuara nga legjislacioni në mënyrë që gjatë grumbullimit të mos kemi ndotje të ambientit, leshimin e aromave të pakëndshme etj. Gjithashtu numri i kërkuar i mjeteve lidhet ngjyeshëm me volumin e zërave të shërbimit dhe distancave të largëta të kryerjes së shërbimit. Përsa i përket autofshesës dhe mjetit për ngarkimin e kazanëve autoriteti ka kërkuar

vetëm disponimin e një mjeti për selicin lloj duke marrë në konsideratë faktin se ky zë shërbimi në rastin e mirëmbajtjes së kontinierëve nuk kryhet përditë por sipas nevojës dhe në rastin e autofshesës sipas një grafiku të caktuar dhe është e mjaftueshme disponimi vetëm i një mjeti të tillë. Përsa i përket autobotëve duke marrë në konsideratë distancat e largëta nuk mund të realizohet ky shërbim vetëm nga 1 mjet. Përsa i përket mjeteve për grumbullimin e mbetjeve ku numër sic cituam më sipër është vendosur duke marrë në konsideratë volumnin e mbetjeve, frekuenca e realizimi të shërbimit sidomos gjatë sezonit turistik dhe distancat e vendeve të grumbullimit.

2.3.9 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund ti vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën, ambient (brenda teritorrit të Bashkisë Himarë) me sipërfaqe jo më të vogël se 800 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokumenti i vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambjenti merret me qera duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë e qiradhënësit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund ti vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën, ambient (brenda teritorrit të Bashkisë Himarë) me sipërfaqe jo më të vogël se 800 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera. Ky kriter shërben për të garantuar autoritetin kontraktor për disponueshmërinë jo vetëm të mjeteve por dhe sigurimin e kushteve për realizimin me sukses të kontratës. Sipërfaqja 800 m² është përcaktuar bazuar në numrin e mjeteve të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Në lidhje me caktimin e kësaj sipërfaqe autoriteti kontraktor ka parashikuar mundësinë që brenda këtij ambienti të kryhet jo vetëm parkimi, por edhe riparimi, sistemi apo dhe mirëmbajtja e mjeteve dhe kontenierëve si dhe qarkullimi i lirë i tyre brenda në “kantier”.

2.3.10 Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një pikë për larjen dhe dezinfektimit të kazanëve (lavazh) në pronësi ose qira në formën e kërkuar nga ligji (certifikatë pronësie nëse është në pronësi, kontratë qiraje nëse është marrë me qira). Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri do të vlerësohet e vlefshme edhe kontratë bashkëpunimi e operatorit ekonomik me një lavazh të licensuar.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë një pikë për larjen dhe dezinfektimin e kazanëve (lavazh) në pronësi ose me qira në formën e kërkuar nga ligji (certifikatë pronësie nëse është në pronësi, kontratë qiraje nëse është marrë me qira ose kontratë bashkëpunimi e operatorit ekonomik me një lavazh të licensuar). Ky kriter shërben të garantuar autoritetin kontraktor për disponueshmërinë jo vetëm të mjeteve por dhe sigurimin e kushteve për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës në studimin e kostove të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të mbështetur nga projekti me titull “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit” i cili bëhet pjesë e pandarë e dokumentave të tenderit. Plani i Menaxhimit të Integruar është ngarkuar në SPE dhe është hartuar nga një grup pune në përbërje të të cilit ka specialist fushe dhe përmban të gjitha të dhënat në lidhje me sasitë, specifikimet teknike/termat e referencës të nevojshme për hartimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë.

Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit: